



Raporti i Performancës

Bashkia Berat

2025



BASHKIA BERAT



Ky botim mbështetet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



Sweden
Sverige



BASHKIA BERAT

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	4
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	5
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë.....	7
Kategoria: Shërbimet.....	8
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	9
Turizmi.....	12
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	15
Administrimi i pyjeve dhe kullotave.....	Error! Bookmark not defined. 20
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	22
Rrjeti rrugor rural	25
Policia bashkiake	27
Qendrës Multifunksionale Rinore Berat	30



BASHKIA BERAT

Hyrje

Ky raport paraqet një analizë të performancës së bashkisë, duke vlerësuar aspektet kryesore të ofrimit të shërbimeve. Në këtë dokument evidentohen arritjet e deritanishme, si dhe fushat ku nevojitet përmirësim.

Qeverisja vendore në Shqipëri ka përjetuar ndryshime të rëndësishme pas miratimit të Ligjit nr.115, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale”, i cili konsolidoi 373 bashki dhe komuna në 61 bashki, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike. Ky proces reformash, i shoqëruar nga Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji “Për financat vendore” (2017), ka zgjeruar kompetencat e bashkisë dhe ka forcuar financat vendore, duke mundësuar rritjen e investimeve dhe autonominë fiskale.

Miratimi i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i hapi rrugë procesit të decentralizimit të funksioneve:

1. Administrimi dhe menaxhimi i pyjeve dhe kullotave;
2. Administrimi dhe menaxhimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse;
3. Administrimi dhe menaxhimi i arsimit parashkollor;
4. Administrimi dhe menaxhimi i rrugëve rurale;
5. Administrimi dhe menaxhimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Vlerësimi i performancës në këtë raport bazohet kryesisht në të dhënat vetëdeklaruese të bashkisë, të mbledhura përmes një procesi konsultues me ekspertë tematikë.



BASHKIA BERAT

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë



Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë Berat përfaqëson një dokument orientues dhe planifikues afatmesëm, i cili synon të promovojë një zhvillim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të integruar për territorin e bashkisë. Strategjia bazohet në potencialet ekzistuese të zonës – veçanërisht trashëgiminë kulturore, resurset natyrore dhe kapitalin njerëzor – si edhe në analizën e sfidave aktuale dhe mundësive për rritje ekonomike. Bashkia Berat synon të forcojë konkurrueshmërinë e territorit, të krijojë më shumë mundësi punësimi, të rrisë cilësinë e shërbimeve publike dhe të përmirësojë mirëqenien e banorëve në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të qeverisjes së mirë.

Bashkia Berat shtrihet në jug-qendër të Shqipërisë, brenda territorit të Qarkut Berat, dhe ka si kryeqendër qytetin e njohur të Beratit. Ky qytet, i njohur si “qyteti i një mbi një dritareve”, është një nga më të vjetrit dhe më të pasurit në trashëgimi kulturore në vend, pjesë e listës së UNESCO-s për vlerat e tij historike dhe arkitektonike. Territori i bashkisë përfshin një zonë kodrinore dhe malore, ku natyra dhe historia ndërthuren në mënyrë harmonike. Lumi Osum përshkon qytetin, duke krijuar një peizazh të veçantë dhe duke i dhënë jetë një mjedisi të pasur me biodiversitet dhe bukuri natyrore. Përveç qytetit të Beratit, bashkia përfshin edhe njësi të tjera administrative si Otllaku, Velabishti, Roshniku dhe Sinja, të cilat përbëhen nga dhjetëra fshatra me tradita të lashta



BASHKIA BERAT

dhe mikpritje të ngrohtë. Mjedis i kulturor i Beratit është i pasur me monumente të trashëgimisë kombëtare dhe rajonale, si Kalaja e Beratit, Muzeu Onufri, lagjet karakteristike Mangalem dhe Gorica, që ruajnë arkitekturën e vjetër dhe frymën autentike të qytetit. Këto elemente e bëjnë Beratin një destinacion të rëndësishëm turistik, duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin ekonomik lokal. Nga ana infrastrukturore, Bashkia Berat ka lidhje të mira rrugore me qytetet përreth si Fier, Lushnjë dhe Elbasan. Megjithatë, disa zona rurale dhe fshatra të largëta përballen me sfida, për shkak të terrenit të thyer dhe distancave të mëdha nga qendra urbane. Përmirësimi i rrjetit rrugor dhe i shërbimeve publike mbetet një prioritet për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm dhe përfshirje të barabartë për të gjithë banorët. Bashkia Berat është një shembull i gjallë i bashkëjetesës mes natyrës, historisë dhe kulturës, duke ofruar jo vetëm një vend për të jetuar, por edhe një hapësirë për të përjetuar thelbin e Shqipërisë.

Zhvillimi ekonomik i Bashkisë Berat është fokusuar në shfrytëzimin e potencialit turistik, përmirësimin e infrastrukturës dhe mbështetjen e ekonomisë vendore. Në vitet e fundit, janë realizuar investime të rëndësishme në restaurimin e zonave historike dhe monumenteve kulturore, duke e kthyer qytetin në një destinacion të rëndësishëm turistik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Projekte infrastrukturore si ndërtimi i urave lidhëse dhe akseve rrugore strategjike kanë lehtësuar qarkullimin dhe kanë rritur qasjen në tregje për komunitetet rurale. Paralelisht, janë ndërmarrë nisma për nxitjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, veçanërisht në fushat e turizmit, shërbimeve dhe prodhimit bujqësor. Ky zhvillim bazohet në një qasje të integruar që synon rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët e Beratit, duke respektuar trashëgiminë kulturore dhe mjedisore të zonës.



BASHKIA BERAT

Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë

Popullsia e Beratit mbetet relativisht e qëndrueshme, dhe kjo tregon se bashkia ka ende një bazë të mirë demografike për zhvillim, veçanërisht nëse investohet në nxitjen e qëndrimit të të rinjve dhe kthimin e emigrantëve përmes zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të cilësisë së jetës.

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Berat city	63134	63125	63036	63042	62747	63505	63406	63408	63514	63428	63395	63262
Roshnik	3929	3911	3896	3896	3705	3896	3672	3658	3602	3578	3546	3534
Otlak	14544	14699	14914	15061	15226	15475	15540	15575	15533	15574	15645	15757
Velabisht	11836	11926	11974	12065	12039	12084	12109	11962	11950	11958	11980	12005
Sinje	5432	5420	5411	5420	5251	5235	5224	5190	5182	5201	5179	5133



BASHKIA BERAT

Kategoria: Shërbimet

Monitorimi i performancës së shërbimeve është një funksion thelbësor për të siguruar cilësinë, qasjen dhe efektivitetin e shërbimeve që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky proces ndihmon në vlerësimin e mënyrës se si bashkia përmbush përgjegjësitë e saj ndaj qytetarëve, duke u bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Përpara shfaqjes së treguesve të një raporti performance, është e rëndësishme të theksohet se monitorimi i shërbimeve nuk kufizohet vetëm në matjen e rezultateve, por përfshin edhe analizën e burimeve të përdorura, procedurave të ndjekura dhe ndikimit real që shërbimet kanë tek komuniteti.

Kjo kategori mbulon disa fusha të rëndësishme të ofrimit të shërbimeve vendore, të cilat lidhen me cilësinë, efikasitetin dhe kënaqësinë e qytetarëve. Vlerësimi i tyre mundëson identifikimin e pikave të forta, sfidave dhe hapësirave për përmirësim në menaxhimin e shërbimeve publike.

Treguesit që përfshihen në këtë kategori do të ndihmojnë në kuptimin e performancës së bashkive në ofrimin e shërbimeve dhe do të shërbejnë si bazë për vendimmarrje më të informuar dhe orientim drejt rezultateve më të mira për qytetarët.



BASHKIA BERAT

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Arsimi parashkollor u transferua në vitin 2016. Ligji 139/2015, i ndryshuar përcakton se bashkitë janë përgjegjëse kryesisht për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave për arsimin parauniversitar, përveç shkollave profesionale, si dhe për administrimin dhe rregullimin e arsimit parashkollor publik, kopshtet. Shumë aspekte të këtij shërbimi trajtohen në bashkëpunim me qeverinë qendrore. Ky funksion nuk është financiar mjaftueshëm, duke ndikuar në cilësinë dhe disponueshmërinë e arsimit. Gjendja e shërbimit arsimor në Shqipëri u vlerësua duke përdorur tre tregues kryesorë: normat e regjistrimit të arsimit parashkollor për fëmijët deri në 6 vjeç, niveli i mirëmbajtjes së objekteve arsimore, dhe raporti fëmijë-mësues.





BASHKIA BERAT

Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Mësimi në klasat e arsimit parashkollor zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i fëmijëve për një punonjës mësimor në arsimin parashkollor	14	12.48	12.8	12.2	12.6	12.5
Rritja e frekuentimit të sistemit parashkollor	Raporti në % i numrit të fëmijëve që frekuentojnë sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve 3 - 6 vjeç	49	49	52	59	61	65



BASHKIA BERAT


Të dhënat e shërbimit

Numri I fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor

Të dhënat për numrin e fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor në Bashkinë e Beratit tregojnë ndryshime për disa vite. Në **2021**, numri i fëmijëve të regjistruar ishte **1326**. Në vitin pasues, **2022**, u shënua një ulje e lehtë, me **1285** fëmijë të regjistruar.. Viti **2023-1131** dhe disa vite të ardhshme, përfshirë **2024-1037**, **2025-1040**, dhe **2026-1042**

E dhëna	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	1285	1190	1131	1037	1040	1045
Klasa në sistemin parashkollor	88	88	79	69	68	67
Numri i mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor	98	98	98	98	98	98
Ndërtesa funksionale të arsimit bazë dhe parashkollor	58	58	57	56	55	55

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikun përkatës.





BASHKIA BERAT

TURIZMI





BASHKIA BERAT

Numri i Turisteve


Viti	2022	2023	2024	2025
Nr i turisteve	400 000	800 000	1 000 000	800000

Të dhënat tregojnë një rritje të ndjeshme të numrit të turistëve nga viti 2022 deri në vitin 2024, e ndjekur nga një ulje në vitin 2025:

- **2022** – 400,000 turistë
- **2023** – 800,000 turistë (dyfishim krahasuar me vitin 2022)
- **2024** – 1,000,000 turistë (viti me fluksin më të lartë)
- **2025** – 800,000 turistë

Duhet theksuar se **vlera e vitit 2025 është e raportuar vetëm deri në muajin tetor**, prandaj pritet që numri final vjetor të jetë më i lartë pasi të përfshihet edhe periudha nëntor–dhjetor. Rënia e përkohshme krahasuar me vitin 2024 nuk përfaqëson domosdoshmërisht një trend negativ, por lidhet me faktin që të dhënat për 2025 nuk janë ende të plota.

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.






BASHKIA BERAT

Numri i njësive akomoduese:

Viti	2022	2023	2024	2025
Njesi akomoduese	130	207	324	375

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.



- Ka një rritje të qëndrueshme të njësive akomoduese gjatë këtyre 4 viteve.
- Rritja më e madhe absolute ndodhi nga 2023 në 2024 (117 njësish).

Zonat me njesi akomoduese me te larte jane Kala, Mangalem, Gorice por edhe qendra e qytetit me lagjiet 22 Tetori dhe 13 Shtatori jane zona me shume njesi akomoduese.

Ne lidhje me numrin e turisteve qe kane fjetur nje nate ne Berat, ne pikun me te larte te turizmit mendohet te jete numri 3200 person



BASHKIA BERAT

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Shërbimi i ujitje-kullimit përfshin mirëmbajtjen e kanaleve dytësore dhe tretësore u transferua bashkive në vitin 2016. Gjatë këtyre viteve është synuar përmirësimi i këtij shërbimi duke investuar në mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture, për të ardhur në ndihmë të fermerëve dhe ekonomive vendore. Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin ose organizimin e sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.





BASHKIA BERAT

Treguesit e shërbimit


Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Përmirësimi i rrjetit ujitës	Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)	2.17	3.82	2.57	3.08	2.87	4
Përmirësim i rrjetit kullues	Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)	6.88	4.39	2.71	3	2.83	4
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje	Raporti në % i sipërfaqes bujqësore të mbuluar me ujitje ndaj sipërfaqes totale bujqësore ndër vite	14.22	14.22	14.22	14.22	14.22	14.22
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim	Raporti në % i sipërfaqes bujqësore të mbuluar me kullim ndaj sipërfaqes totale bujqësore	27.77	27.77	27.77	27.77	27.77	27.77



BASHKIA BERAT

Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.





BASHKIA BERAT

Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem kullues (në ha)	4100	4100	4100	4100	4100	4100
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem ujitës (në ha)	2100	2100	2100	2100	2100	2100
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	14760	14760	14760	14760	14760	14760
Rrjet kullues në pronësi të bashkisë në total në km	490	490	490	490	490	490
Rrjet ujitës në pronësi të bashkisë në total në km	824	824	824	824	824	824
Diga funksionale	10	10	10	10	10	10
Rrjet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km	17.9	31.5	21.3	25.4	23.7	
Rrjet kullues i mirëmbajtur/pastruar në km	33.7	21.5	13.3	14.7	13.9	
Inspektime në sistemin ujitës dhe kullues	20	24	23	22	25	
Diga të mirëmbajtura	1	1	0	2	1	




BASHKIA BERAT

Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe visual

 *Rrjet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km*

 *Rrjet kullues i mirëmbajtur/pastruar në km*



Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Pas zbatimit të Reformës Administrative-Territoriale, bashkive në Shqipëri iu ngarkua përgjegjësia për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave, përjashtuar zonat e mbrojtura. Ky ndryshim synon forcimin e rolit të qeverisjes vendore në menaxhimin e burimeve natyrore, rritjen e përgjegjshmërisë, si dhe afrim më të madh të shërbimeve pranë komuniteteve. Përmes këtij procesi, bashkitë marrin një rol të drejtpërdrejtë në ruajtjen, përdorimin e qëndrueshëm dhe zhvillimin e këtyre pasurive natyrore, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien ekonomike dhe sociale të banorëve. Bashkia është përgjegjëse për sigurimin e administrimit të shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullosor, shfrytëzimin e racionalizuar të rezervave pyjore dhe kullosore, konservimin dhe zgjerimin e tyre. Bashkia siguron mikëqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore, dhënien e licencave për prerje pemësh, ripyllëzime, kontrole të dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë.



BASHKIA BERAT

Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2021	2022	2023	2024	2025
Numri i punonjësve për menaxhimin pyjeve dhe kullotave	4	4	5	5	5
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor (në ha)	16401.57	15767	15767	15767	15767
Kontrolle dhe inspektime të fondit pyjor dhe kullosor	108	137	128	144	158
Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plane mbarështimi në ha		15767	15767	15767	15767
Sipërfaqe pyjore në të cilën është shtuar pyllëzimi (në ha)	1.3	7.6	1	1	0.5
Numri i rezervuarve malorë të rikonstruktuar	1	1	2	2	1
Prita malore të rikonstruktura	2	1	0	0	0



BASHKIA BERAT

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Funksioni i menaxhimit të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi iu transferua Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në vitin 2016. Në kuadër të Reformës Administrative-Territoriale, deri në fund të vitit 2018 u ngritën stacionet zjarrfikëse në çdo bashki, secili me një strukturë minimale prej 14 punonjësish. Analiza e këtij shërbimi mbështetet kryesisht në dy tregues kryesorë: numrin e zjarrfikësve për çdo 1.500 banorë dhe numrin e automjeteve zjarrfikëse për çdo 10.000 banorë. Në nivel kombëtar, raporti aktual është afërsisht një zjarrfikës për 1.500 banorë. Një tendencë e ngjashme vërehet edhe në aspektin e mjeteve zjarrfikëse, ku disponueshmëria e tyre bie në raport me rritjen e madhësisë së bashkive. Bashkia është përgjegjëse për të siguruar funksionimin e njësive zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimit në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.





BASHKIA BERAT

Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024	2025
Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH	Total shpenzime për MZSH kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara në lekë	92299.42	131360.53	63842.93	60745,09	72940.16



BASHKIA BERAT

Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2021	2022	2023	2024	2025
Numri i stacioneve MSZH	1	1	1	1	1
Total shpenzime për mzsh (në lekë)	31751000	49917000	32,687,576	38,937603	46,389,939
Koha e daljes nga stacioni (në sekonda) (mesatarja ditën dhe natën)	40	40	40	40	40
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit nga MZSH	344	380	512	641	636



BASHKIA BERAT

Rrjeti rrugor rural

Ky shërbim përfshin ndërtimin, mirëmbajtjen dhe sinjalizimin e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit, duke përfshirë rrugët, urat, tunelët, parkimet, терминаlet e autobusëve, rrugët këmbësore dhe korsitë për biçikleta, nën administrimin dhe përgjegjësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ai përfshin gjithashtu kryerjen e studimeve për rehabilitimin, përmirësimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja, si dhe marrjen e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e rrjetit rrugor rural të njësisë.

Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2021	2022	2023	2024	2025
Rrjeti rrugor në km linear në total (rural/urban)	857	857	857	857	857
Gjatësia e rrjetit rrugor urban nën administrimin e bashkisë në km	242	242	242	242	242
Gjatësia e rrjetit rrugor rural nën administrimin e bashkisë në km	615	615	615	615	615



BASHKIA BERAT

Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	14764	14764	14764	14764	14764	14764
Sipërfaqe e tokës bujqësore e kultivuar (në ha)	11440	11440	11440	11440	11440	11440
Sipërfaqja e tokës bujqësore e gërryer nga lumi osum	43	43	43	43	43	43
Fondi i tokës bujqësore shtetërore	3324	3324	3324	3324	3324	3324
Numri I regjistrimeve të akteve të marrjes së tokës në pronësi	11240	11240	11240	11240	11240	11240
Numri i shërbimeve ndaj fermerëve	350	200	300	780	1020	



BASHKIA BERAT

Policia bashkiake

Ky shërbim siguron mbrojtjen, qetësinë dhe mbarëvajtjen e jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror. Ai përfshin gjithashtu ekzekutimin e akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe zbatimin e vendimeve të Këshillit të Njësisë. Performanca e shërbimit vlerësohet përmes treguesve kryesorë: raporti në përqindje i ankesave dhe konflikteve të zgjidhura ndaj numrit të tyre total në polici, raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake ndaj numrit total të punonjësve të policisë bashkiake, dhe raporti në përqindje i punonjësve të trajnuar ndaj numrit total të punonjësve.





BASHKIA BERAT

Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Punonjësit e policisë bashkiake gëzojnë statusin sipas ligjit	Raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake kundrejt numrit total të punonjësve të policisë bashkiake	6.67	6.67	6.67	13.3	13.3	13.3
Rritja e numrit të ankesave të qytetarëve që janë menaxhuar nga policia bashkiake	Raporti në % i ankesave dhe konflikteve të zgjidhura kundrejt numrit të tyre në total të ardhur në policinë bashkiake	111.11	100	100	100	100	100



BASHKIA BERAT

Të dhënat e shërbimit


Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Numri total i punonjësve të policisë bashkiake	15	15	15	15	15	15
Punonjës me statusin oficer të policisë bashkiake	1	1	1	2	2	2
Raste konfliktesh/mosmarreveshjes të zgjidhura nga policia bashkiake	50	76	88	95	102	
Numri i rasteve të konflikteve/mosmarrëveshjeve të raportuara dhe regjistruara në policinë bashkiake	45	76	88	95	102	



BASHKIA BERAT

Qendrës Multifunksionale Rinore Berat



Shërbimet Multifunksionale Rinore **synojnë të krijojnë një hapësirë gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për të rinjtë**, ku ata mund të zhvillojnë aftësitë e tyre personale, sociale dhe profesionale. Konkretisht, ky shërbim ka disa qëllime kryesore:

- Fuqizim personal dhe profesional i të rinjve
- Zhvillim kreativ dhe aftësish praktike
- Pjesëmarrje aktive në komunitet
- Ambient i sigurt dhe gjithëpërfshirës për studim dhe aktivitete sociale/kulturore



BASHKIA BERAT

Emërtimi/Viti	2022	2023	2024	2025	Gjithsej 2022-2025
Numri total i aktiviteteve	99	73	88	70	330
Numri total i të rinjve të përfshirë në aktivitete të organizuara në Qendër	2719	1763	2340	1640	8462